



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, nenit 17 të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_, të miratojë këtë :

## PROPOZIM

### VENDIM

### **PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK -LIPJAN**

#### Neni 1

#### **Përbërja e Komisionit**

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK-Lipjan për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK-Lipjan 15Nr. \_\_\_\_\_ i datës \_\_\_\_\_ (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1.Valon Pacolli, nga ekzekutivi i Komunës,

2. Sead Aliu, nga ekzekutivi i Komunës,

3. \_\_\_\_\_ anëtar i kuvendit nga subjekti politik LDK,

4. \_\_\_\_\_ anëtar i kuvendit nga subjekti politik PDK dhe

5. \_\_\_\_\_ nga sektori joqeveritar lokal

## Neni 2

### Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

## Neni 3

### Mandati i anëtarëve

Manadati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK-Lipjan për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK-Lipjan 15Nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_.

## Neni 4

### Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

## Neni 5

### Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nënligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori për Çështje Pronësore-Juridike.

## Neni 6

### Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

## Neni 7

### Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

### Arsyetim

Baza juridike për të propozuar Vendimin është e përcaktuar me dispozitat e nenit 58 shkronja h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 40 shkronja h.) e Statutit të Komunës së Lipjanit.

Baza juridike dhe obligimi ligjor për të miratuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare

e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Komisioni vlerësues formohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK-Lipjan për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK-Lipjan 15Nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_, konform nenit 17 paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me të cilin nen përcaktohet që për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës formohet komisioni vlerësues.

Anëtari i pestë i Komisionit nga subjekti joqeveritar lokal zgjidhet përmes shpalljes publike.

Nga të cekurat më lartë, kërkohet nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 020/04-18035  
Lipjan, 20.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

